



Instituti Shqiptar i Medias
Albanian Media Institute

Vështrim mbi faqet kulturore dhe artistike në shtypin e përditshëm shqiptar

*(Monitorim i katër gazetave të përditshme dhe një të
përjavshmeje)*

Nga Virgjil Muçi

*Ky monitorim është prodhuar me mbështetjen financiare të Ambasadës Amerikane.
Përmbajtja e këtij monitorimi është përgjegjësia e vetme e autorit dhe në asnjë
rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Ambasadës Amerikane.*

1. Hyrje. Vështrim i përgjithshëm

Me kënaqësi konstatojmë se ndryshe nga katër vjet më parë peizazhi i shtypit kulturor dhe artistik në faqet e të përditshmeve shqiptare ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme. E megjithatë, me keqardhje vëmë re se edhe sot që shkruajmë këto radhë nuk ka një gazetë mirëfilli letrare. Po kështu në tregun mediatik mungojnë revistat e përmuajshme me profil të qartë letrar dhe/ose artistik. Në mënyrë të çrregullt vazhdojnë të dalin revistat “Përpyekja” (e cila është më shumë një revistë e mendimit kritik), “Aleph” dhe “Mehr Licht” (ndërsa këto dy të fundit me profil të qartë letrar e kulturor), ekzistenca e të cilave është gati-gati një heroizëm, duke qenë se e kanë të pamundur të mbajturit prej shitjeve ose prej publikimit të reklamave, ndaj dhe botuesit e tyre, njerëz të letrave, janë të shtrënguar të trokasin në dyert, shpesh të shurdhëta, të sponsorëve të ndryshëm. Mund të themi se deri më sot nuk ka një politikë nga ana e qeverisë për të marrë në mbrojtje këtë *specie* në zhdukje e sipër. E vërteta është se një organ kulturor e letrar i mirëfilltë duke mos qenë në gjendje të konkurrojë në kushtet e tregut e ka të vështirë, për të mos thënë të pamundur, ekzistencën pa mbështetje financiare të institucioneve ose, të themi kështu, të mecenatëve të ndryshëm. Ndaj dhe, siç do ta shohim më poshtë, krejt barra e mbulimit dhe e pasqyrimit të jetës kulturore e artistike shkon e bie mbi *supet e brishtë* të shtypit të përditshëm.

2. Përshkrimi i metodës

Duke qenë se ky punim nuk synon të kapërthejë krejt problematikat e shtypit shqiptar në përgjithësi dhe as të atij kulturor në veçanti, çka do të ishte një sipërmarrje pothuajse e pamundur po të kemi parasysh larminë dhe shumëllojshmërinë e medias së shkruar në vendin tonë, vështrimi ynë fokusohet në katër të përditshme: Gazeta Shqiptare, Shekulli, Panorama e Shqip, si dhe në një organ të përjavshëm, revistën “Klan”, më e hershmja dhe më qëndrestarja, në qoftë se mund të shprehemi kështu, ndër simotrat e saj pas viteve nëntëdhjetë.

Përzgjedhja kohore përfshin muajin tetor, i cili, tradicionalisht, ka qenë një stinë e begatë me veprimtari kulturore dhe artistike; ndërsa përqëndrimi te gazetat e lartpërmendura ka të bëjë si me profilin e tyre tashmë të konsoliduar në mediane e shkruar shqiptare, ashtu edhe me përvojën shumëvjeçare të gazetarëve/gazetareve që mbulojnë art & kulturën.

Ndryshe nga vështrimi i hedhur në vitin 2007 ku u përqëndruam më fort në hapësirat që i kushtoheshin kulturës, shpeshësisë dhe mënyrës se si shkruheshin artikujt kritik për librin, por edhe për fusha të tjera të krijimtarisë artistike, si filmi, ekspozitat e artit pamor, teatri etj., vëmendja që u kushtohej burimeve, sa vend zinin intervistat me personazhe të artit e të kulturës dhe teknika e formulimit të pyetjeve, përzgjedhjes që u bëhej ngjarjeve artistike e kulturore dhe, herë pas here, ndonjë vështrim krahasues i mbulimit të së njëjtës dukuri kulturore nga një gazetë e një tjetër, vëzhgimi i këtëhershëm prek mbulimin e jetës kulturore dhe artistike prej çdonjërës nga të përditshmet e zgjedhura prej nesh në pesë data të muajit tetor dhe më konkretisht më 2, 9, 16, 23 dhe 30, data që korrespondojnë me ditët e diela të këtij muaji. Kjo gjë bëhet për dy arsye: së pari, lënda e pasqyruar prej gazetave është shumë e ngjeshur dhe mjaft e vështirë për t'u trajtuar sipas një paradigme krahasimtare ose tematikore; dhe, së dyti, për të krijuar një ide sa më konkrete për hapësirat që gazetat përkatëse lënë në dispozicion të art & kulturës në veprimtarinë e tyre të ditëpërditshme.

3. Këqyrja sipas datave dhe çdonjërit prej organeve të shtypit

2 tetor 2011

“Gazeta Shqiptare”

Siç e cekëm edhe në hyrje të punimit tonë “Gazeta Shqiptare” është e vetmja ndër të përditshmet e zgjedhura prej nesh që ka një suplement kulturor e letrar me 12 faqe të titulluar “Milosao”, redaktore përgjegjëse e të cilit është Admirina Peçi. Në numrin e kësaj date suplementi me një profil të plotë të shkrimtarit Besnik Mustafaj, profil ky i

ilustruar edhe me foto nga fëmijëria e shkrimtarit. Profili përmban një intervistë të gjatë, si dhe një ese që shkrimtari ia kushton gjyshit të tij.

Më pas suplementi vazhdon me një shkrim të piktorit dhe kritikut Abaz Hado rreth portretit të piktorit shkodran Kol Idromeno “Motra Tone”. Në faqen përbri gjendet një studim i Gazmend Krasniqit rreth pionerit të Rilindjes Naim Frashëri. Ajo çka përbën risi në vështrimin tonë është faqja letrare e suplementit ku shohim të botohen një tufë vjershash nga poetja Lindita Agolli. Natyrshëm gjen vendin e vet në faqet e këtij suplementi edhe kritika letrare, e cila, këso here, i kushtohet romanit “Globi në rrjetë” të shkrimtarit disident Astrit Delvina. Shkrimi kritik mban firmën e Bujar Leskajt, autor i një libri me shënime rreth krijimtarisë të shkrimtarëve të dënuar nga diktatura.

Suplementi mbyllet me një artikull të Stefan Çapalikut rreth filmit “Falja e gjakut” të regjisorit amerikan Joshua Marston, me skenar të shqiptarit Andamion Murati.

Ajo çka të bie në sy lënda e këtij suplementi është mbulimi i plotë jo vetëm tematik, por edhe i ngjarjeve kryesore të jetës artistike e kulturore. Nga ana tjetër lypset vlerësuar fakti se, redaktorja përgjegjëse ka ofruar të japin kontributet e tyre njerëz që tanimë e kanë trajtësuar profilin e tyre në fushë të krijimtarisë ose të kritikës letrare e artistike. Vlen të theksohet se nga pikëpamja grafike shkrimet shoqërohen me fotografi dhe ilustrime të ndryshme.

Gazeta “Panorama”

Duke qenë se të dielën në këtë gazetë zë një vend të konsiderueshëm suplementi “Unë gruaja”, kultura vërtet zhvendoset në rrafsh të dytë, por, gjithsesi, nuk mbetet në hije dhe vijon të jetë e pranishme. Më konkretisht në faqen e parë has në rubrikën e përhershme të përkthyesit dhe shkrimtarit Edmond Tupja, i cili, ndonëse në editorialet e veta trajton problematika të ndryshme, në më të shumtën e rasteve e bën këtë gjë nga këndvështrimi i njeriut të kulturës e të letrave. Ndërkohë që, si në faqet e gazetës ashtu edhe në suplementin e përmendur, Art&Kulturës nuk zë ndonjë vend të veçantë. Gjithsesi duhet të theksojmë se përtej kësaj, mbulimi që i bëhet ngjarjeve, personazheve dhe problematikave kulturore në ditët e tjera të javës është i plotë dhe i

shumanshëm. E theksojmë këtë gjë për t'u pasur në konsideratë edhe në vështrimet që do të hidhen gjatë ditëve të tjera.

Gazeta "Shekulli"

Kjo gazetë e cila prej kohësh vjen me një *look* të ri, qysh në faqen e parë ngërthen dy episode që lidhen me kulturën dhe debatin intelektual. I pari ka të bëjë me një polemikë të shkrimtarit Rudolf Marku me historianin Luan Malltezi lidhur me një debat që prek çështje tejet sensitive të historisë së Shqipërisë, siç është qëndrimi ndaj tezës së hedhur nga historishkruesit turq, por jo vetëm, se Perandoria Osmane nuk duhet këqyrur si pushtuese por si administruese në Shqipëri e në Kosovë e ndonjë vend tjetër dhe, për rrjedhojë, rishkrimit të historisë në këtë aspekt. Ç'është e vërteta, Shekulli ka qenë kurdoherë i hapur dhe një nga forumet kryesorë të debateve të nxehta kulturore të intelektualëve shqiptarë kudo që ata jetojnë.

Episodi i dytë ka të bëjë me një intervistë të gazetares me përvojë në lëmë të kulturës Elsa Demo me regjisorin britanik Rex Bloomstein, i cili ka qenë i pranishëm në Festivalin e Filmit për të Drejtat e Njeriut që zhvillohet nga Akademia Marubi në Tiranë. Intervista shoqërohet me foto të regjisorit dhe nga filmat e tij. Nën okelion Shkurt pasqyrohen disa prej ngjarjeve më të rëndësishme të jetës artistike në vend.

Gazeta "Shqip"

Shfaqet e pasur në lëndë me përmbajtje kulturore ditën e dielë. Më shkoqur në suplementin e përditshëm "Ndryshe" ka një artikull të gjatë për regjisorin amerikan me origjinë shqiptare Sten Dragoti të shkruar nga skenaristi Avdulla Kënaçe. Ndërsa më pas vërejmë se faqja 28 i kushtohet krejtësisht librave të rinj të hedhur së fundmi në treg dhe, ç'është më e rëndësishme, gazetarja Alda Bardhyli ia kushton recensën e vet librit autobiografik "Margot Asquith". Në faqen 29 kemi një intervistë me aktoren Rina Narazani dhe ndonjë njoftim të shkurtër nga kronika kulturore. Ashtu si dhe në gazetatat e lartpërmendura edhe Shqip i kushton një vëmendje të posaçme faqosjes dhe paraqitjes grafike të faqeve kulturore, duke i pasuruar ato me fotografi dhe elementë të tjerë ilustrativë.

Revista “Klan” 7 tetor 2011

Edhe pse ka një profil të qartë politik e social, “Klan” i kushton vëmendje edhe kulturës nëpërmjet një rubrike të rregullt me recensione për librat, por edhe me trajtimin e problematike të ndryshme që kanë të bëjnë me jetën kulturore dhe artistike në vend. Në numrin në fjalë spikat intervista e gazetarit Renato Kalemi me mbesën e shkrimtarit nobelist grek Niko Kazanxaqis, mjaft i njohur në Shqipëri për shkak të botimit të disa prej veprave të tij madhore.

Më tej, në faqen 34 kemi një shkrim problematik me titull “Libri si biznes”, i cili trajton një sërë problematikash që lidhen me industrinë e botimeve, si dhe konfliktet e shfaqura mes botuesve shqiptarë në prag të panairit të librit. Shkrimi përmban edhe një intervistë me kryetarin e njëres prej shoqatës së botuesve shqiptarë, z. Petrit Ymeri.

Në faqen 45 revista Klan boton një recensë për librin e javës. Bëhet fjalë për një rubrikë të qëndrueshme prej afro 15 vjetësh, e para e këtij lloji në shtypin shqiptar, si dhe shoqërohet me njoftimin e tre titujve të botuar kohët e fundit. Njoftimet janë të pajisur me kopertinat e librave dhe të dhënave me karakter teknik.

9 tetor 2011

“Gazeta Shqiptare”

Në numrin e saj të së dielës kjo gazetë hapet në mënyrë intriguese me *duelin* midis dy personazheve publikë, botuesit Fatmir Toçi dhe shkrimtarit Ben Blushi, që të dy deputetë në Kuvendin e Shqipërisë dhe anëtarë të Partisë Socialiste. Siç mund të kuptohet në brendësi, faqen 3, përmes intervistës me botuesin Toçi, bëhet fjalë për divorcin e bujshëm me shkrimtarin dhe deklaratat pikante të njërit e tjetrit.

Ndërsa suplementi “Milosao” i po kësaj date i kushtohet pothuaj ekskluzivisht poetit Migjeni në 100 vjetorin e lindjes së tij. Në të gjen dy shkrime të gjatë të studiuesve të njohur të letrave shqipe Nasho Jorgaqi dhe Alfred Uçi. Është mbresëlënësi fakti që kjo

gazetë i kushton hapësirën e merituar një personazhi të jashtëzakonshëm të letërsisë shqipe, siç ka qenë Migjeni, për të cilin është heshtur, jo pa tendencë, për një periudhë të gjatë kohe, sidomos pas viteve nëntëdhjetë.

Po në këtë numër të Milosaos hasim një fotoreportazh të pazakontë rreth Çamërisë së fillimit të shekullit të njëzetë nga fotografi zviceran Frederik Bouasona. Më pas vijohet me një shkrim të gjatë për shkrimtarin e njohur Dritëro Agolli, për t'u mbyllur me dy artikuj të gjatë kritik që lidhen me artin pamor, njëri prej tyre homazh për piktorin dhe një prej kritikëve të rrallë të tij Llambi Blido.

Gazeta “Panorama”

Kjo gazetë në këtë numër ka një shkrim të gjatë të Alket Çanit të botuar tek editorialet për librin me kujtime “Më kujtohet” të Ylli Demnerit. Ndërsa në brendësi të suplementit “Unë gruaja” boton një shkrim të gjatë për pjesën e Aristofanit “Gratë në parlament” të vënë në skenën e Teatrit të Metropolit në Tiranë. Shkrimi shoqërohet edhe me një intervistë të gazetares me një prej aktorëve protagonistë të kësaj drame.

Mund të themi se ashtu si edhe një numër më parë, kjo gazetë nuk i kushton dhe aq vëmendje kulturës në këtë numër.

Gazeta “Shekulli”

Në numrin e së dielës “Shekulli” ia kushton faqet e kulturës një shkrimi të Lekë Tasit me temë nga historia e Shqipërisë, i cili merr shkas nga ekspozita me ekspozate historike hapur nga Artan Lame dhe Petraq Gramo në Muzeun Historik, Tiranë. Shkrimi shoqërohet me një fotografi interesante të mbretëreshës Elisabetë të Rumanisë, e njohur me emrin letrar Karmen Silva, e cila ishte e emta e Princ Vidit, mbretit jetëshkurtër të Shqipërisë.

Po në këtë numër, në faqen përbri, gazeta boton një lajm rreth ndërhyrjes në një veprimtari shkencore në Bullgari të gjuhëtarit Bardhyl Demiraj, si dhe një informacion të përmbledhur lidhur me vënien në skenë të operës “Flauti magjik” të Moxartit.

Gazeta “Shqip”

Në suplementin e vet “Ndryshe” gazeta i kushton plot një faqe nobelistit suedez Tomas Transtromer. Shkrimi është i poetit shqiptar nga Maqedonia, Agim Vinca dhe shoqërohet me fotografi të poetit.

Në faqen 28 që ashtu si çdo të dielë kjo gazetë ia kushton rubrikës për libra të rinj, krahas njoftimeve për një pjesë të botimeve më të fundit të hedhur në treg, kemi edhe një shkrim për shkrimtarin bashkëkohor amerikan Philip Roth, i botuar gjerësisht kohët e fundit edhe në Shqipëri. Pranë këtij shkrimi kemi edhe një shkrim kritik për romanin e një autori shqiptar, Isidor Koti, shkruar nga Dorian Koçi.

Në faqen përbri gazeta boton një intervistë me këngëtaren Alma Bekteshi, si dhe na përcjell disa njoftime shkurt për kronikën kulturore të lidhur me vendin tonë.

Revista “Klan”

Kjo revistë e datës 14 tetor nuk ka ndonjë prurje të prekshme në fushë të kulturës. Këtë herë është mjaftuar me rubrikën e përhershme të librit, dhe njoftimet e disa prej titujve të rinj në libraritë e vendit, si dhe me një faqe nën okelion Kinema që ia kushton filmave amerikanë të prodhuar kohët e fundit.

16 tetor 2011

“Gazeta Shqiptare”

Në dymbëdhjetë faqet e saj “Milosao” na sjell një larmi tematikash dhe figurash të njohura të artit e të kulturës shqiptare, si të traditës ashtu edhe bashkëkohore. Separati, të cilin fare mirë mund ta këqyrim edhe për një minigazetë letrare e artistike, jo dhe aq prej numrit të faqeve, po për shkak të larmisë tematike, hapet me një rrëfim të poetit Lasgush Poradeci rreth figurës së Migjenit, sipas një artikulli të gjatë të shkrimtarit dhe studiuesit të letrave shqipe, Nasho Jorgaqi. Punimi ndiqet nga një

tjetër punim i muzikologut Vasil Tole rreth vënies në muzikë të vargjeve të Migjenit. Më pas vijohet me poezi dhe proza poetike të dy autorëve Arben Orhani dhe Uk Lushi dhe një vështrim mbi artin ikonografik të kishës së Shën Kollit në Mesopotam. Këtij numri nuk i mungon shkrimi kritik, i cili, këtë herë, i kushtohet politikanit dhe shkrimtarit Pjetër Arbnori dhe është shkruar nga një tjetër personazh i politikës dhe i pasionuar pas letrave Bujar Leskaj. Me një shkrim për piktorin e traditës së vonë të pikturës shqiptare, Vangjush Mio, të shkruar nga kritikja e artit pamor Suzana Varvarica, mbyllet edhe ky numër i “Milosaos”.

Gazeta “Panorama”

Të bie në sy se në qysh në faqen e parë kjo gazetë hapet me një polemikë midis dy krerëve të lartë të shtetit lidhur me çështjes së gjuhës, por e cila nuk ka të bëjë dhe aq me çështjet e gjuhës dhe standardit të saj, aq fort të diskutuara sot e gjithë ditë mes gjuhëtarëve dhe njerëzve të letrave në përgjithësi, por me luftën politike mes këtyre personazheve të skenës politike shqiptare. Po kështu në rubrikën e editorialeve ka një shkrim polemizues lidhur me taksat për artistët nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha, të shkruar nga një artiste e re, Inida Gjata, e cila i drejtohet me një letër të hapur kryetarit të ri të bashkisë, duke e qortuar atë për politikën e tij fiskale në lidhje me artistët e rinj që punojnë si të pavarur.

Ndërkohë në suplementin “Unë gruaja” të drejtuar nga gazetarja Alma Mile, e njohur dhe me përvojë si gazetare e kulturës, ajo i kushton një hapësirë të veçantë këngëtares së njohur Pavlina Nika, të ndarë nga kjo jetë kohët e fundit. Suplementi, i cili, siç e thamë, trajton më shumë figurat dhe problemet e grave kryesisht në shoqërinë tonë, shpesh i kushton vëmendje edhe grave që vinë nga fusha e arteve dhe e kulturës. Po në këtë numër kemi edhe një portret të aktorit australian Hugh Jackman.

Gazeta “Shekulli”

Në numrin e kësaj date, kjo gazetë njofton qysh në faqen e parë një shkrim për Migjenin të poetit dhe publicistit Rudolf Marku. E theksoj këtë gjë se e këqyr si një risi dhe peshë e rol që merr kultura, madje shpesh edhe duke iu mbivendosur shkrimeve të politikës së ditës, siç ngjet në rastin në fjalë. Në brendësi të gazetës, dhe

më konkretisht në faqet 14-15, përveç shkrimit të Markut, hasim edhe një polemikë të Lekë Tasit me një shkrim të botuar para dy numrash të “Milosao” lidhur me kujtimet e një bashkëkohësi të Migjenit që kallzonte se si poeti e kishte humbur virgjërinë në një shtëpi publike *me njërën nga ato*. Vlen të theksohet se shkrimet shoqërohen me fotografi të shumta e mjaft interesante, por dhe me një faqosje tejet funksionale dhe të këndshme për syrin estetikisht. Veç shkrimeve për Migjenin, në faqen 15 gjejmë edhe një shkrim promocional rreth një artisti të ri e të verbër Emiliano Lule, fitues i programit “Bota ndryshe”.

Më tej, në faqen 18, gazetarja e kulturës Jorida Pasku interviston pedagogen e muzikës Ilirjana Dema, rreth krijimtarisë së kompozitorit të njohur shqiptar Aleksandër Peçi. Po në këtë numër kemi edhe një shkrim në faqen 19 që flet për rikthimin në skenë të aktorese së njohur Edi Luarasi, dikur të persekutuar nga diktatura. Shkrimi për të është në suazë të kujtimit të dy dëshmoreve të Luftës Nacional Çlirimtare, Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima, figurën e njërës prej tyre ka personifikuar aktorja e shquar në një film të viteve shtatëdhjetë.

Gazeta “Shqip”

Në suplementin e vet të përditshëm “Ndryshe”, kjo gazetë i kushton një hapësirë dyfaqëshe shkrimtarit bashkëkohor japonez Haruki Murakami me rastin e botimit të romanit të tij më të fundit “1Q84”, të shoqëruar me foto dhe kopertina librash. Shkrimtari në fjalë është bërë i njohur edhe në vendin tonë përmes botimit të disa prej romaneve të tij.

Ndërsa në faqet e kulturës kjo gazetë i kushton hapësirë dokumentarit për Ismail Kadarenë të realizuar nga Top Chanel. Shkrimet janë të gazetares Oliverta Lila. Në të dy faqet e shkrimit bien në sy fotografitë e shumta të shkrimtarit, si dhe skena nga puna për realizimin e filmit dokumentar.

Revista “Klan”

Në numrin e datës 21 tetor, kjo revistë boton një shkrim problemor të gazetares Alida Cenaj me titull “Komedia e Teatrit të Komedisë”. Shkrimi shoqërohet me fotografi të

drejtorit të këtij teatri të miratuar nga qeveria, por ende jo funksional, si dhe trajton pengesat dhe labirinthin e korridoreve të burokracisë së dikastereve dhe strukturave që merren me kulturën. Kjo revistë ka edhe një profil të këngëtares së xhazit Eda Zari me rastin e recitalit të saj të parë në Tiranë. Më pas vijohet me rubrikat e përhershme të librit dhe të produkteve më të fundit kinematografike në botë.

23 tetor 2011

“Gazeta Shqiptare”

Në faqet 14-15 që kjo gazetë ia kushton këtë numër kulturës kemi një shkrim të Auron Tares lidhur me incidentin e kanalit të Korfuzit në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, si dhe një shkrim rreth kërkesës së ministrit të Kulturës, Aldo Bumçi, drejtuar autoriteteve të Bibliotekës së Vatikanit për kthimin në Shqipëri të veprës “Meshari” të Gjon Buzukut.

Në faqet e suplementit “Milosao” përveç materialeve të shumta me karakter historik rreth Çamërisë dhe rolit të çamëve gjatë luftës së fundit botërore, të shoqëruara me foto të shumta dhe të papublikuara më parë, kjo gazetë i kushton vëmendje, si përherë, edhe shkrimtarëve bashkëkohorë, në rastin konkret Fatos Kongoli, me një bashkëbisedim të tijin me shkrimtarin francez Jacques Jouet, si dhe krijon hapësirë për shkrim kritik rreth romanit të fundit të Zija Çelës me titull “Apokalipsi sipas Shën Tiranës”. Ndërkohë që pjesën e luanit, thënë kështu, ia kushton poetit të shquar At Gjergj Fishta në 140 vjetorin e lindjes së tij. Shkrimet e shumta rreth kësaj figure komplekse jo vetëm të letrave, por edhe të jetës dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi, shoqërohen edhe me një *antologji* të krijimtarisë së pasur e të shumëllojshme të autorit, si dhe me një tufë vjershash që i kanë kushtuar këtij personaliteti poetët bashkëkohorë. Një punim rreth publicistikës fishtiane shkruar prej At Vitor Demajt analizon mendimin dhe gjykimin kritik fishtian dhe aktualitetin që ruan edhe sot e kësaj dite, pas më shumë se shtatëdhjetë vjetësh.

Suplementi mbyllet me një shkrim të gjatë të kritikut të arteve figurative, Abaz Hado, rreth portretit në pikturën shqiptare si një Rilindje e vonuar.

Gazeta “Panorama”

Ashtu siç e njofton qysh në faqe të parë, me titull dhe fotografi me ngjyra të diktatorit Hoxha, kjo gazetë, nën okelion Speciale, i kushton një vëmendje të veçantë me shkrime dhe fragmente të shkëputur prej librit, veprës së gazetarit Blendi Fevziu rreth figurës së Enver Hoxhës. Fotografitë e botuara në këtë numër janë një tekst më vete, duke qenë se pasqyrojnë retushimet që bëheshin asokohe pas çdo spastrimi që kryhej në radhët e udhëheqjes së partisë.

Në suplementin “Unë gruaja” i kushtohet një faqe një emisioni televiziv me titull “Gra të lira” dhe personazheve të tij, ku bien në sy figura të spikatura femrash të ekranit dhe të penës.

Gazeta “Shekulli”

Edhe gazeta e kësaj date hapet me fotografi dhe headlines kushtuar botimit të librit me titull “Kurban” dhe, s’do mend, autorit të tij, kryetarit të Partisë Socialiste, Edi Rama. Por e pazakontë në këtë faqe të parë është editoriali i Koloreto Cukalit, i cili shkruan për filmin e fundit të regjisorit danez Lars von Trier, duke e trajtuar si një problem kulturor faktin që dashamirët e kinemasë nuk kanë asnjë mundësi ta shohin në ato pak kinema të kryeqytetit, dhe e vetmja mundësi e tyre është që të bëjnë kopje pirate të filmit. Vërtet një shkrim që ngjall interes! Po kaq interesant është edhe editoriali i shkruar prej Ardian Vehbiut, i cili në shkrimin e vet shtjellon një sërë problemesh në thelb kulturore të Shqipërisë së sotme që zënë fill me gjuhën, historinë, shoqërinë klasën politike e kështu me radhë e me vister.

Në faqet 16-17 të rubrikës me titull Jetë, gazeta sjell një shkrim të Alfred Çapalikut lidhur me 140 vjetorin e poetit Gjergj Fishta, shkrim që shoqërohet me fotografi të shumta. Veç tij këto faqe përmbajnë edhe një njoftim tejet interesant të nxjerrë nga arkivat rreth një filmi dokumentar për Shqipërinë e vitit 1945 të xhiruar nga shkrimtari i shquar frëng Romen Rolan. Në faqen përkundruall gjejmë edhe disa njoftime Shkurt nga kronika e jetës artistike në Tiranë.

Gazeta “Shqip”

Ashtu si në çdo numër suplementi “Ndryshe” i kësaj gazete sjell si një zbulim të rëndësishëm nga fusha e letrave gjetjen e një drame për heroin tonë kombëtar, Skënderbeun. Shkrimi është i studiuesit Musa Ahmeti, i njohur edhe më parë për scope-e të kësaj natyre. Punimi shoqërohet me facsimile të shumta nga drama në fjalë dhe zë dy faqe të plota.

Në rubrikën e përjavshme kushtuar botimeve të reja, Shqip sjell një informacion të pasur, si dhe një shkrim promovues për librin e shkruar nga dy gazetarë italianë për një grup muzikor. Ndërsa në faqen përmbri lexuesi gjen një intervistë të gjatë me shkrimtarin Zija Çela me rastin e botimit dhe promovimit të romanit të tij më të fundit në Shkup. Në të dyja faqet shkrimet dhe njoftimet shoqërohen me foto kopertinash dhe të autorëve të librave.

Revista “Klan”

Në numrin e fundit të muajit tetor, kjo revistë ia kushton kopertinën e shoqëruar me foton ngashënjyese të një miss-i, ngjarjes nga bota e spektaklit që lidhet me organizimin e Miss Globe. Por në vështrimin tonë qershia mbi tortë e këtij numri të Klanit është portreti për fotografimin e njohur turk me nënë shqiptare, Goksin Sipahioglu, shkruar nga shkrimtari dhe publicisti Luan Rama, i cili ka vizituar Tiranën në periudhën diktaturës, duke na sjellë disa fotografi të jashtëzakonshme për kryeqytetin më të hermetizuar të krejt planetit. Veç ëndjes estetike fotot janë edhe një dokument i pazëvendësueshëm historik për kohën.

Në faqen 39 revista ka huazuar nga Newsweek një shkrim rreth filmit “Anonymus”, i cili trajton subjektin e njohur që vë në dyshim autorësinë e dramaturgut të madh anglez, Shekspirit, mbi veprat e tij. Lypset theksuar fakti se Klan herë pas here i hap faqet e tij për shkrime të huazura nga revista të huaja, duke cituar me korrektësi burimin.

30 tetor 2011

“Gazeta Shqiptare”

Në njoftimin në kokë të gazetës për suplementin “Milosao”, lexuesi bëhet me dije rreth librit të Ben Blushit, si dhe botimit të një fragmenti të tij. Njoftimi përcillet me foto të autorit dhe të kopertinës së librit. Në brendësi të gazetës, domethënë në hapësirën që i kushtohet si çdo të dielë suplementit, redaktorja përgjegjëse sjell një intervistë të vetën me botuesin e librit, si dhe ashtu siç njoftonte në krye, edhe një fragment të shkurtër të romanit.

Suplementi vijon me një shkrim të Jonila Godoles rreth poetit Rainer Maria Rilke, e cila është edhe sjellësja në shqip e poetit të shquar austriak. Ndërsa në faqen 22 kemi një portret të shkurtër të poetit Dylan Thomas që shoqërohet me një grusht poezish të përkthyer në shqip.

Në dy faqe të suplementit Admirina Peçi sjell një intervistë të gjatë me shkrimtarin Ylljet Aliçkaj, rreth krijimtarisë dhe jetës së tij. Teksa nga blloku i kujtimeve shohim të botojë një punim me tepër vlera të shkrimtarit dhe studiuesit Dhimitër Shuteriqi rreth figurës së pazbuluar plotësisht të mendimtarit Branko Merxhani.

Suplementi mbyllet me një shkrim të shkurtër rreth dokumentarit të Ilir Matit të vlerësuar me çmim në një festival në Itali, dhe që shoqërohet me fotografi të nxjerra nga dokumentari.

Gazeta “Panorama”

Kjo gazetë njofton në faqen e parë me tituj dhe fotografi me ngjyra rreth debatit mediatik të ndezur pas botimit të librit me kujtime të Helena Kadaresë dhe sidomos rreth disa deklaratave të saj hot për marrëdhëniet e të shoqit, shkrimtarit të njohur me femra të tjera. Më konkretisht në faqet e suplementit të vet të së djelës “Unë gruaja” gazetarja dhe përgjegjësjë e tij Alma Mile shkruan një editorial me titullin këmbues

“Helena, e vetme kundër botës, për dashurinë”. Në brendësi lexuesi gjen disa fragmente të shkrimtares së njohur, si dhe fotografi të saj me të shoqin.

Më tej në suplement hasim në portretet e disa prej drejtueseve të emisioneve më të njohura televizive, ndër to edhe emra të njohur nga bota e skenës.

Gazeta “Shekulli”

Në numrin e së dielës gazeta hapet me foton e botueses Dudaj, njëkohësisht botuese e librit të Edi Ramës, si dhe me titujt e mëdhenj në qendër “Panairi, dëbohet ‘Kurbani’ i Ramës”, duke iu referuar kësaj librit të kryetarit të Partisë Socialiste.

Në brendësi, në rubrikën “Jetë”, lexuesi sheh një intervistë të gjatë dhe të shoqëruar me një fotografi familjare të këngëtarit e kompozitorit të muzikës së lehtë, Ardit Gjebrea, njëkohësisht edhe showman i Klanit.

Kjo gazetë mbyllet me një portret të shkrimtarit nobelist peruan Mario Vargas Llosa.

Gazeta “Shqip”

Çuditërisht në këtë numër të fundit të tetorit suplementi “Ndryshe” nuk ka asgjë të re nga fronti i arteve dhe i kulturës. Ndërkohë që në rubrikën e përjavshme të librave të rinj ka një shkrim të gazetares Oliverta Lila rreth librit me kujtime të shkrimtarit dhe studiuesit të njohur të letrave shqipe, Nasho Jorgaqi, si dhe një shkrim pa emër për botimin më të fundit të Moikon Zeqos. Më tej, si përherë, vijohet me tituj e rinj që kjo gazetë ka përzgjedhur këtë numër.

Në rubrikën Personazh gazeta ka një shkrim të gjatë për aktorin e njohur Enver Petrovci, me titullin provokues “Do t’u mësoj aktorëve si flitet gjuha shqipe”. Shkrimi në fjalë shoqërohet me foto të aktorit.

Me këtë gazetë mbyllet edhe vështrimi ynë rreth faqeve kulturore dhe artistike të gazetave të sipërpërmendura.

4. Përfundime. Konsiderata të përgjithshme.

Hapësira që i caktohet Artit & Kulturës, nën emrin përgjithësues Kulturë është ku më pak, ku më shumë e njëjtë të të gjitha gazetat e përditshme. Më konkretisht bëhet fjalë për një hapësirë të përhershme prej dy-tre faqesh të përditshme, të cilat gjenden më së shumti pas rubrikës së Koment & Opioneve dhe para lajmeve nga bota ose lajmet sportive. Nga të pesë gazetat e përzgjedhura për këtë monitorim vetëm Gazeta Shqiptare ka një suplement mirëfilli Kulturor & Letrar, të titulluar “Milosao”, i cili ka 12 faqe dhe del një herë në javë, të dielën. Gazetat e tjera kanë hapësira speciale, në qoftë se mund të shprehemi kështu, nën tituj e rubrika të ndryshme ku gjejnë pasqyrim arti dhe kultura, sidomos personazhet e tyre, shkrimtarë, artistë etj. Ndryshe nga katër vite më parë vëmë re se hapësira në dispozicion të shtypit kulturor nuk ka ardhur duke u rrudhur, por, përkundrazi, ka fituar terren. Dhe ky është një lajm i mirë. Falë kjo edhe një sërë çështjesh të mprehta nga historia, gjuha e politika që janë pasqyruar në një sërë botimesh të kohëve të fundit.

Përsa i përket elementëve teknikë siç janë faqosja dhe design-i në përgjithësi është e vështirë të pikasësh ndryshime thelbësore nga njëra gazetë në tjetrën. Bie në sy gazeta „Shekulli“ me një *look* të ri, siç e theksuam edhe më lart. Pozitiv është fakti që të gjitha gazetat kanë arkivat e tyre të fotografive, çka bën që të shmanget uniformiteti. E megjithatë krahas fotografive mendojmë se mund të gjejnë më shumë vend portretet dhe sidomos karikaturat. Kësisoj faqet e kulturës kishin për të qenë edhe më të larmishme nga ana konceptuale, duke bërë që të shmangej edhe ndonjë ngjashmëri që vihet re ngandonjëherë dhe që lidhet me tematikën e ngjashme që shpesh janë të shtrënguara të mbulojnë.

Këqyrur në mënyrë krahasuese me punimin tonë të para katër vjetëve kostatojmë një prani më të madhe e më të shpeshtë të kritikës së specializuar për gjini të ndryshme të artit, fjala vjen, muzikë, pikturë, kinematografi, teatër etj.

Gjithsesi çka përshkruam më sipër është vetëm një fragment i mozaikut të faqeve kulturore të shtypit të përditshëm shqiptar. Ndaj u kërkojmë ndjesë gjithë atyre të

përditshmeve, si dhe gazetarëve/gazetareve që japin një ndihmesë të vyer në këtë fushë dhe që nuk mundëm t'ua përmendim emrin.

b) Rekomandime.

- Organizimi i seminareve dhe kurseve të trainimit ku të ftohen, veç lektorëve, edhe shkrimtarë, kulturologë, e artistë gjithfarësh për të diskutuar e rrahur mendime me gazetarët/ret sidomos me ata/ato që janë rishtarë.
- Shkëmbim përvojash me gazetarë të huaj dhe kolegë sidomos nga vendet fqinje, çka do të ndihmonte në njohjen e ndërsjelltë të produkteve artistike e kulturore bashkëkohore dhe të politikave e problematikave në këtë fushë.
- Krijimi i një network-u kulturor mes gazetarëve të rajonit të Ballkanit për të ndihmuar në shkëmbimit e informacionit mes tyre dhe lehtësimin e punës së shoku-shokut. Fjala vjen, kësisoj, përveç huazimeve të shkrimeve të njëri-tjetrit, gazetarët e kulturës mund edhe t'i vijnë në ndihmë njëri-tjetrit për t'u lidhur me shkrimtarë, kineastë dhe artistë gjithfarësh për t'i intervistuar e shkruar rreth tyre.
- Krijimi i një çmimi vjetor për gazetarët e kulturës si stimul për punën dhe kontributin e tyre në këtë fushë. Këtë çmim mund ta japin Shoqata e Botuesve për *book review* më të mirë për vitin, mund ta japë Instituti i Medias ose cilido institut tjetër që lëvron projekte në këtë fushë për gazetarin/en më të mirë të vitit, por kurrësi Ministria e Kulturës ose institucione në vartësi të saj (siç është folur shpesh), çka do të komprometonte panashmërinë dhe besueshmërinë profesionale të gazetarit e të gazetës.
- Hartimi i një kodi të etikës kulturore, diçka e ngjashme me dhjetë komandamentet (urdhëresat) e gazetarit që rendit Adam Michniku, si masë e peshë gjykimi dhe vlerësimi moral për gazetarët/ret, veçanërisht ata të rinj.